

ALBANIAN DIGITAL PRINTING SOLUTIONS & SERVICES Sh.p.k

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakëve të Albanian Digital Printing Solutions & Services sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë Albanian Digital Printing Solutions & Services sh.p.k, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Albanian Digital Printing Solutions & Services sh.p.k** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



Luan Kamberi
Partner Angazhim

29 mars 2016

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	5,870,610	1,868,174
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	35,982,217	23,694,337
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	229,866	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	156,860	19,195
Inventari	8	7,418,366	9,785,104
Shpenzime të shtyra	9	2,660,812	998,089
Total Aktive Afatshkurtra		52,318,731	36,364,899
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	26,970,690	32,971,146
Aktive afatgjata jomateriale	11	60,989	73,941
Total aktive afatgjata		27,031,679	33,045,087
Total Aktive		79,350,410	69,409,986
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	3,134,956	1,394,613
Llogari të pagueshme tregtare	13	22,804,326	11,727,627
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	14,554,398	21,929,291
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	38,762	103,525
Detyrime tatimore	16	2,757,108	1,731,197
Të tjera detyrime	17	16,363	1,154,994
Total Detyrime afatshkurtra		43,305,913	38,041,247
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	18	9,593,441	15,155,250
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	19	2,676,960	2,732,730
Total Detyrime afatgjata		12,270,401	17,887,980
Totali i detyrimeve		55,576,314	55,929,227
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	20	100	100
Rezerva ligjore		10	10
Rezerva të tjera		13,480,649	8,803,776
Fitimi i ushtrimit		10,293,337	4,676,873
Total kapitali		23,774,096	13,480,759
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		79,350,410	69,409,986

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	104,522,075	115,542,481
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		273,188	63,059
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	22	249,125	(42,580)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(68,873,235)	(74,627,544)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	23	(64,194,814)	(69,909,360)
2) Të tjera shpenzime	24	(4,678,421)	(4,718,184)
Shpenzime të personelit	25	(16,554,008)	(25,408,590)
1) Paga dhe shpërblime		(14,842,786)	(23,516,207)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetsore		(1,711,222)	(1,892,383)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10/11	(6,364,256)	(7,460,335)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(79,531)	(15,614)
Të ardhura të tjera			
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare	27	(856,588)	(1,761,215)
Shpenzime interesi dhe			
1) shpenzime të ngjashme		(1,129,721)	(1,744,055)
2) Shpenzime të tjera financiare		273,133	(17,160)
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		12,316,770	6,289,662
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(2,023,433)	(1,612,789)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(2,023,433)	(1,612,789)
Fitimi/humbja e vitit		10,293,337	4,676,873
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		10,293,337	4,676,873

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	100	10	861,726	7,942,050	8,803,886
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël					
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					-
Fitimi / Humbja e vitit				4,676,873	4,676,873
Lëvizjet përmes kapitalit			7,942,050	(7,942,050)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	100	10	8,803,776	4,676,873	13,480,759
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				10,293,337	10,293,337
Lëvizjet përmes kapitalit			4,676,873	(4,676,873)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100	10	13,480,649	10,293,337	23,774,096

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më 07 Mars 2016:

Elvis Sula
Elvis Sula

Administrator



Mazars shpk

Hartues i Pasqyrave



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		10,293,337	4,676,873
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative		(331,616)	22,403
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		444,375	398,078
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		6,364,256	7,460,335
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(14,318,134)	908,026
Rënie/(rritje) në inventarë		2,366,738	(3,370,236)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		3,798,686	(1,333,588)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		(718,739)	33,583
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		7,898,903	8,795,474
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(350,847)	(3,088,777)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(350,847)	(3,088,777)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Pagesa e huave		(3,544,821)	(3,965,527)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(3,544,821)	(3,965,527)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		4,003,235	1,741,170
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		1,868,174	132,249
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		(799)	(5,245)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	5,870,610	1,868,174

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Mars 2011 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërise është 100 Lekë, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1 Lekë secila.

Ortakët e shoqërise janë :

- Z. Elvis Sula zotërues i 24.5 kuotave ose 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Wildermore Holdings zotërues i 24.5 kuotave ose 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Inform P.Lykos S.a Processing & Development of Printed Information System zotërues i 51 kuotave ose 51% të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje e shtypshkrimeve dixhitale dhe menaxhim i të gjitha llojeve të dokumenteve dhe shtypshkrimeve. Tregti e të gjitha produkteve të ngjashme dhe makinerive që lidhen me këtë lloj aktiviteti. Shtypshkrim dhe menaxhim i dokumenteve me elemente sigurie. Përfaqësim në Shqipëri i shoqërive të huaja me aktivitet të ngjashëm.

Adresa e selisë së shoqërisë është: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 18 punonjës (2014: 16 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (Vazhdim)

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/ALL	137.28	140.14
USD/ ALL	125.79	115.23

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

1. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

2. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Mjete monetare në bankë	5,818,803	1,667,694
Llogari rrjedhëse	5,818,803	1,667,694
Mjete monetare në arkë	51,807	200,480
	5,870,610	1,868,174

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Klientë	35,982,217	23,694,337
	35,982,217	23,694,337

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të arkëtueshme tregtare nga Inform P.Lykos	229,866	-
	229,866	-

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Detyrime doganore	156,860	19,195
	156,860	19,195

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Lëndë e parë dhe materiale	6,956,847	9,001,622
Mallra për rishitje	125,273	720,423
Produkt i gatshëm	336,246	63,059
	7,418,366	9,785,104

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime të periudhave të ardhme	2,660,812	998,089
	2,660,812	998,089

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	47,030,472			2,765,593	1,212,232	51,008,297
Shtesa		953,836	52,167	97,311	1,957,481	3,060,794
Pakësime						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	47,030,472	953,836	52,167	2,862,904	3,169,713	54,069,091
Shtesa			20,874	289,190	40,783	350,848
Pakësime						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	47,030,472	953,836	73,041	3,152,094	3,210,496	54,419,939
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	(12,549,381)			(845,843)	(251,141)	(13,646,365)
Amortizimi i vitit	(6,494,474)	(158,970)	(11,333)	(492,842)	(293,961)	(7,451,580)
Pakësime						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	(19,043,855)	(158,970)	(11,333)	(1,338,685)	(545,102)	(21,097,945)
Amortizimi i vitit	(5,245,797)	(158,973)	(8,862)	(411,392)	(526,280)	(6,351,304)
Pakësime						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	(24,289,652)	(317,943)	(20,195)	(1,750,077)	(1,071,382)	(27,449,249)
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	34,481,091	-	-	1,919,750	961,091	37,361,932
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	27,986,617	794,866	40,834	1,524,219	2,624,611	32,971,146
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	22,740,820	635,893	52,846	1,402,017	2,139,114	26,970,690

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	86,346	86,346
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	86,346	86,346
Amortizimi		-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	12,405	12,405
Amortizimi i vitit	12,952	12,952
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	25,357	25,357
		-
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2014	73,941	73,941
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2015	60,989	60,989

12. Huat aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Overdraft Raiffeisen Bank	3,134,956	1,394,613
	3,134,956	1,394,613

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë vendas	13,462,027	9,457,591
Furnitorë të huaj	9,342,299	2,270,036
	22,804,326	11,727,627

14. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të pagueshme tregtare ndaj Inform P.Lykos	14,554,398	21,929,291
	14,554,398	21,929,291

(Vlerat janë në Lek)

15. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë për fatura të pambërritura	38,762	103,525
	38,762	103,525

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	265,884	261,775
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	114,641	665,331
Tatim në Burim	1,142,790	185,321
Tatim fitimi	444,375	239,906
TVSH për t'u paguar	789,418	378,864
	2,757,108	1,731,197

17. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Detyrime ndaj personelit	-	718,739
Përfitime afatshkurta nga sigurimet	-	36,394
Të tjera detyrime	16,363	399,861
	16,363	1,154,994

18. Hua afatgjata

Huatë afatgjata detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Qera Finaciare Raiffeisen Leasing	6,473,915	11,849,538
Qera Finaciare Porsche Leasing	442,566	572,982
Finacim Kostas Grekis	2,676,960	2,732,730
	9,593,441	15,155,250

(Vlerat janë në Lek)

19. Të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Finacim Elvis Sula	2,676,960	2,732,730
	<u>2,676,960</u>	<u>2,732,730</u>

20. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100 Lek. Gjate vitit 2015 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shitja e produktit të vet	75,041,493	87,776,993
Të ardhura nga shitja e mallrave	8,019,094	16,002,045
Të ardhura nga shërbimet	21,461,488	11,763,443
	<u>104,522,075</u>	<u>115,542,481</u>

22. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Fitime nga këmbimt valutore	691,012	102,017
Humbje nga këmbimet valutore	(441,887)	(144,597)
	<u>249,125</u>	<u>(42,580)</u>

(Vlerat janë në Lek)

22. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	123,371,062
Autofatura të deklaruar për blerje shërbime nga jashtë shtetit	(18,836,356)
Diferencë kursi nga parapagimet	(12,631)
Shitje te deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	104,522,075
Shitje produkte të gatshme	75,041,493
Shitje mallrash	8,019,094
Shërbime	21,461,488
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	104,522,075
Ndryshimi i gjendjes së PG	273,188
Fitim nga këmbimet valutore	964,145
Total të ardhura të deklaruar në FDP e Tatim Ftimit	105,759,408

23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Kosto e materialeve të para	30,879,205	38,062,761
Kosto e materialeve të ambalazhimit	584,397	700,189
Pjesë këmbimi	3,769,448	6,384,250
Materiale të tjera ndihmëse	58,858	55,489
Kosto e mallrave të shitur	7,027,600	13,997,708
Nënkotaktorë	15,658,958	2,242,054
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	1,607,178	3,117,456
Qera	3,187,194	2,994,011
Prime sigurimi	210,610	196,586
Energji elektrike	880,943	1,239,939
Shërbime nga të tretë	330,423	918,917
	64,194,814	69,909,360

(Vlerat janë në Lek)

24. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime qeraje	-	28,090
Mirëmbajtje dhe riparime	261,165	255,300
Shpenzime për licensë software, konfigurim , setup	-	134,809
Shpenzime administrative dhe noteriale	38,953	75,763
Konsulenca ekonomike dhe juridike	1,814,732	802,492
Shërbime nga të tretë	382,610	805,760
Blerje të ndryshme,kancelari etj	121,806	276,867
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	505,518	552,027
Komisione bankare	252,202	265,679
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	184,214	125,953
Dhurata	-	21,000
Taksa të ndryshme	20,120	20,320
Kosto udhëtimi dhe akomodimi teknikët	306,976	633,948
Siguracione	8,100	-
Shpenzime për pritje	68,320	-
Shpenzime pjesmarrje në tender	294,000	-
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	419,705	720,176
	4,678,421	4,718,184

25. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	14,566,040	20,520,713
Shpenzime për sigurime shoq. e shënd.	1,711,222	1,892,383
Qera apartamenti për punonjësit	267,923	1,618,799
Shpenzime të tjera për punonjësit	8,823	1,376,695
	16,554,008	25,408,590

(Vlerat janë në Lek)

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoba dhe penalitete	79,531	15,614
	79,531	15,614

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(1,129,721)	(1,744,055)
Humbje nga këmbimet valutore	-	(29,349)
Të ardhura nga këmbimet valutore	273,133	12,189
	(856,588)	(1,761,215)

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	12,316,770	6,289,662
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë):	1,172,785	4,462,268
Shpenzime pritje & përcjellje		21,000
Shpenzime udhëtimi		1,370,695
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	79,531	15,614
Shpenzime interesash të panjohura		225,116
Shpenzime të tjera	1,093,254	2,829,843
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	13,489,555	10,751,930
Tatim fitimi @15%	2,023,433	1,612,789
	10,293,337	4,676,873

(Vlerat janë në Lek)

29. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Inform P.Lykos SA	229,866	14,554,398		21,929,291
Elvis Sula		2,676,960		2,732,730
	229,866	17,231,358		24,662,021

29. Transaksionet me palët e lidhura

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Inform P.Lykos SA	233,047	9,278,407	4,853,035	34,465,415
	233,047	9,278,407	4,853,035	34,465,415

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

30. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2015, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

31. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.